



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1367, datë 25.08.2010

Për

“Miratimin e publikimit të perfundimeve të keshillimit publik “Mbi dhenien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz që ofrojnë shërbime me brez të gjere (UMTS)” dhe njoftimin për kufizimin e numrit të të drejtave të përdorimit të frekuencave””.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku në mbledhjen e datës 25.08.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e publikimit të perfundimeve të keshillimit publik “Mbi dhenien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz që ofrojnë shërbime me brez të gjere (UMTS)” dhe njoftimin për kufizimin e numrit të të drejtave të përdorimit të frekuencave””.

BAZA LIGJORE:

1. Gërma 4 e nenit 68 të ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Dokumenti “Udhëzues për Procedurat e Keshillimit me Publikun” miratuar me VKD nr.1183 , date 10.03.2010;

3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si me poshte:

- perfundimeve te keshillimit publik “Mbi dhenien e te drejtave te perdorimit ne brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz qe ofrojne sherbime me brez te gjere (UMTS)
- shkresa Nr.3135 dt.19.08.2010 e Ministrit per Inovacionin dhe Teknologjine e Informacionit e te Komunikimit “Miratimi i Autorizimit Individual ne brezin e frekuencave qe ofrojne sherbime ne brez te gjere te njohura si 3G”.
- dokumenti i njoftimit te kufizimit te numrit te te drejtave
- projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- mendime formale te paleve te interesuara te depozituara me shkrim ne AKEP;
- diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Dokumentacioni per “Miratimin e publikimit te perfundimeve te keshillimit publik “Mbi dhenien e te drejtave te perdorimit ne brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz qe ofrojne sherbime me brez te gjere (UMTS)” dhe njoftimi i kufizimit te numrit te te drejtave per dhenien ne perdorim **brezin e frekuencave 1920-1935 MHz ciftuar me 2110-2125 MHz dhe 1900-1905 MHz spektër i paciftuar** eshte pergatitur ne perputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator perkates.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë:

-Perfundimet e keshillimit publik “**Mbi dhenien e te drejtave te perdorimit ne brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz qe ofrojne sherbime me brez te gjere (UMTS)**”

- Njoftimin e kufizimit të numrit të të drejtave për dhënien në përdorim të **brezit te frekuencave 1920-1935 MHz ciftuar me 2110-2125 MHz dhe 1900-1905 MHz spektër i paciftuar**

bazuar në germen 4 te nenit 68 te ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*), si dhe Pika 17 e nenit 21 të Rregullores së Brendëshme,

V E N D O S:

1. Të miratojë publikimin e perfundimeve të keshillimit publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz që ofrojnë shërbime me brez të gjërë (UMTS)”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Të miratojë Njoftimin e kufizimit të numrit të të drejtave për dhënien në përdorim të **brezit të frekuencave 1920-1935 MHz ciftuar me 2110-2125 MHz dhe 1900-1905 MHz spektër i paciftuar**, sipas dokumentit bashkëlidhur.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**

RELACION
SHPJEGUES MBI PROJEKTAKTIN

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) ne zbatim te Vendimit Nr.1260, datë 28.04.2010, te Keshillit Drejtues, nisi proceduren e keshillimit publik per “dhenien ne perdorim te brezave te frekuencave 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz qe ofrojne sherbime me brez te gjere (UMTS)”.

Ne perfundim te afatit prej 30 ditesh Grupi i punes i ngritur me Urdherin nr.560 dt.28.04.2010 i perbere nga:

Ibsen Elezi Kryetar

Frederik Kote anetar

Dule Dervishi anetar

Shefqet Meda anetar

Jonida Gjika anetar

Arben Prasta anetar

administroi materialet e mberritura ne AKEP. Kishin bere komente gjithsejt 4 (kater) sipermarres ne lidhje me “**dhenien ne perdorim te brezave te frekuencave UMTS qe ofrojne sherbime me brez te gjere**”, dhe konkretisht nga kater operatoret e telefonise se levizshme GSM ne tregun tone (AMC, Vodafone, Eagle dhe Plus Mobile4AL).

Grupi ka pergatitur materialet:

- 1- “Perfundimet e Keshillimit Publik per dhenien ne perdorim te brezave te frekuencave 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, dhe 2110-2170 MHz **per sherbimet UMTS (Universal Mobile Telecommunications System)**”
- 2- Njoftimin e kufizimit të numrit të të drejtave për dhënien në përdorim të **brezit te frekuencave 1920-1935 MHz ciftuar me 2110-2125 MHz dhe 1900-1905 MHz spektër i paciftuar.**

GRUPI I PUNES

Pergatiti Grupi i punes:

Ibsen Elezi Kryetar

Frederik Kote anetar

Dule Dervishi anetar

Shefqet Meda anetar

Jonida Gjika anetar

Arben Prasta anetar

“Perfundimet e Keshillimit Publik per dhenien ne perdorim te brezave te frekuencave 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, dhe 2110-2170 MHz per sherbimet UMTS (*Universal Mobile Telecommunications System*)”

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) ne zbatim te Vendimit Nr.1260, datë 28.04.2010, te Keshillit Drejtues, ka nisur proceduren e keshillimit publik per “**dhenien ne perdorim te brezave te frekuencave 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz qe ofrojne sherbime me brez te gjere (UMTS)**”.

Ne perfundim te afatit prej 30 ditesh te percaktuar ne vendimin e mesiperme te KD, rezulton se ne adrese te AKEP kane ardhur komente dhe mendime ne lidhje me “**dhenien ne perdorim te brezave te frekuencave UMTS qe ofrojne sherbime me brez te gjere**”, nga palet e interesuara te cilat per aresye konfidencialiteti nuk jepen me emra por me shkronja A, B, C dhe D.

Te interesuarit ju kane dhene pergjigje pyetjeve te adresuara ne dokumentin e keshillimit publik si dhe kane bere komente e kane dhene opinionone ne lidhje me kete dokument.

Keto komente paraqiten ne vijim te ketij dokumenti, respektivisht :

Pyetja:

1- Cilat sherbime dhe aplikime do te garantojne suksesin e rrjeteve UMTS?

A-

UMTS ose ndryshe sistemi i komunikimeve celulare te gjenerates se trete, permireson sherbimet multimediale, aksesin per internet te shpejte me brez te gjere ne celular. Duke perdorur aparate telefonike 3G ne rrjetin 3G realizohen thirrje video call, shikim direkt ne TV me cilesi te larte, marrja e dergimi i e-maileve me kapacitet me te madh, shkarkimi i kengeve , si dhe sherbime te tjera me vlere te shtuar. Perverc ketyre sherbimeve , nje sukses tjetër i rrjeteve UMTS eshte se ato ofrojne shpejtesi te larte megabit per sekonde, krahasuar me shpejtesine e ofruar nga rrjetet kabllore.

Celularet nuk jane me thjesht aparate telefonike, ato jane mjet i fuqishem dhe eficient per komunikimin, informacionin, edukimin, shendetin, mjedisin dhe sigurine publike. Rrjetet UMTS sigurojne sukses ne aplikime dhe sherbime te shumellojshme si me poshte :

- Permiresimi i Sistemit Arsimor- mesimi ne distance e con arsimimin pertej kufijve fizike te klasave dhe librarive te shkollave, duke u dhene mundesine studenteve te kene akses nga cdo vend apo te komunikojne me mesuesit.*
- Permiresimi i sherbimit shendetesor-zgjidhjet 3G kane ndihmuar kujdesin shendetesor dhe kane provuar se jane mjaft efektive ne kapercimin e shume sfidave duke sjelle sherbimet me te fundit mjekesore tek pacientet dhe duke shkëmbyer informacion ndermjet specialisteve te mjekesise.*
- Permiresimi i sigurise publike-rrjetet UMTS mundesojne shtetet dhe qeverite e tyre te kapercenje sfidat sociale dhe ekonomine qe ato shfaqin sot dhe ne te ardhmen.*
- Mundesi te reja sipermarrese-Me ane te aksesit ne internet, njerezit nga cdo ane e Shqiperise apo biznesi, do te perfitojne nga aplikimet e UMTS te cilat lejojne aksesin dhe te dhenat ne kohe reale, gjithashtu do te eliminojne dhe reduktojne kostot ndermjetese.*

B-

Duke u nisur nga eksperiencia e vendeve perendimore si dhe nga kushtet specifike te tregut te telekomunikacionit ne Shqiperi, besojme se sherbimi i Aksesit dhe perdorimit te Internetit do te jene sherbimet qe do te gezojne popullaritet me te madh ne vendin tone. Kjo bazohet ne faktin qe po evidentohet nje kerkese ne rritje per keto sherbime, ne nje kohe qe oferta e tregut eshte shume e limituar si ne mbulim te popullates ashtu dhe ne cilesine e sherbimit qe ofrohet. Mendojme se sherbimet e tjera qe mundesohen nga kjo teknologji (telefonata, video, shkarkim kontenti, etj) do te kene penetrim me te vogel, pasi kushtezohen shume edhe nga aparatet celulare ne perdorim.

C-

Rrjetet UMTS ofrojne aplikime dhe sherbime te reja ne krahasim me rrjetet tradicionale GSM/GPRS/EDGE. Mes ketyre do te permendim sherbimin e thirrjeve me video, transferimi i te dhenave ne High Speed Downlink dhe Uplink (deri ne 84 Mbps UL), paketa aplikimesh streaming, etj.

Nuk ka asnje garanci per suksesin e rrjeteve UMTS bazuar ne keto sherbime. Ne menyre qe te synohet drejt nje rrjeti te sukseshem UMTS, operatoret duhet te bejne perpjekje per t'i ofruar perdoruesve sherbime terheqese si nga ana teknike ashtu dhe komerciale.

Sukse i rrjeteve UMTS do te bazohet kryesisht ne ofrimin e thirrjeve, SMS-ve dhe video-ve, navigimit te shpejte ne internet dhe sherbimeve multimediale (kenge, ringtone, video klipe, kamera vezhguese ne distance, etj).

Gjithashtu, mund te ofrohet dhe nje game e gjere sherbimesh si me poshte:

- *Video conference*
- *Shkarkim fila-sh (P2P)*
- *Mobile instant messaging (MIM)*
- *Sherbime me baze vendndodhje*

Duke perfitur nga avantazhet e shpejtesise se te dhenave, qe mund te ofrojne rrjetet UMTS, mund te implementohen aplikime te reja si e-banking, e-commerce, Video on Demand (VOD), etj.

Ne rastin e Shqiperise, e cila ka nje nivel te ulet te penetrimit te internetit, ne besojme se ofrimi i aksesit te internetit nepermjet teknologjise UMTS, abonenteve aktual dhe atyre te ardhshem, do te rrise ndjeshem numrin e perdoruesve te internetit .Nga ana tjeter, infrastruktura ekzistuese GSM e operatoreve actual celulare, do te shkurtoje kohën qe do te nevojitej per te ofruar akses me brez te gjere ne zona urbane dhe vecanerisht ne ato rurale.

Ne gjithashtu besojme se, duke marre ne konsiderate situaten aktuale te tregut te komunikimive elektronike dhe faktin qe Qeveria Shqiptare po i kushton prioritet te lare transformimit ne nje shoqeri informacioni (permes projekteve si e-government, e-learning, e-commerce, etj), sukcesi i rrjeteve UMTS do te jete i garantuar.

D-

Suksesi i sherbimeve UMTS ne Shqiperi do te varet nga nje sere faktoresh, perfshi shtrirjen e rrjeteve UMTS, si psh:

- *Kerkesa ne treg*
- *Niveli shume i ulet i penetrimit te internetit me brez te gjere*
- *Cmimet e perballueshme te sherbimeve*
- *Kosto e shtrirjes se rrjetit dhe e operimit*
- *Kosto (cmimi) i autorizimeve*

- Maturiteti i teknologjise
- Konkurrenca

Jane disa faktore pozitive qe e favorizojne suksesin, si p.sh pritshmeria per nje treg terheqes, kerkesa, aspiratat e shqiptareve per te ndjekur ritmin e vendeve Europiane, penetrimi ne nivel te ulet i aksesit fiks me brez te gjere (DSL). Gjithashtu, teknologjia 3G eshte e maturuar dhe ka evoluar ne HSPA+, gje qe siguron per klientin nje eksperience me te mire se sa sherbimi ekzistues DSL qe disponohet ne vend.

Nga ana tjeter, ekzistojne disa sfida realiste nga pikepamja e kosos, te cilat rrjedhin kryesisht nga permasa e vogel e rrjeteve ne Shqiperi, terreni i veshtire per t'u mbuluar, kosto te larta operacionale, per shkak te standarteve te infrastruktures qe njihen (rruget, energjia elektrike, siguria etj).Pritshmeria per mundesine e klienteve per te perballuar kete sherbim eshte qartazi me te ulta se ne vendet e tjera Europiane, per arsyen e dukshme te PBB me te ulet per fryme ne Shqiperi. Konkurrenca eshte tashme e forte ndermjet sherbimeve aktuale GSM me tre operatore qe veprojne aktualisht ne treg dhe nje operator te katert qe pritet te hyje ne treg.

Ne kete kontekst, qasja qe duhet te ndiqet per dhenien e autorizimeve individuale nga ana e AKEP dhe Qeverise eshte shume e rendesishme per suksesin e shtrirjes se rrjeteve UMTS ne vend.

Strategjia e rritjes maksimale te tarifave (cmimit) te autorizimeve mund te rrezikojte shpejtesine e shtrirjes se rrjeteve dhe mundesin per perballimin e tyre, ndersa nje qasje e moderuar qe favorizon konkurrencen, investimet dhe mundesine per perballimin e tyre mund te kontribuojte pozitivisht ne shtrirjen e rrjetit UMTS ne vend dhe perfundimisht per suksesin e tij.

Ne mendojme se rrjetet UMTS do te sherbejne si mjetet kryesore qe do te mundesojne penetrim te shpejte te internetit me brez te gjere ne Shqiperi, qe mbeshtet shume produkte dhe sherbime inovative. Eksperienca e tregjeve te tjera sugjeron se teknologjia UMTS konkretisht ka nxitur aksesin e shpejte ne internetin me brez te gjere nepermjet dhenies se aksesit te levizshem me brez te gjere (ne laptop/netbook qe perdorin “ dongles “ dhe pajisje te integruara) dhe ofrimin te internetit te levizshem (ne celulare dhe gjithnje e me shume ne smartphones, si Blackberry dhe iPhones), qe eshte nje propozim shume me i gjere.Sherbimet dhe aplikacionet e tjera (d.m.th video telefoni, tv celular) qe mundesohen nga kjo teknologji i drejtohen me se shumti segmenteve te kufizuara, qe rezultojne ne konsumin jo masiv.UMTS do te te ofrojne gjithashtu kapacitet shtese te zerit , duke perdorur teknologji me eficente ne vend te rrjetit GSM ekzistues.

Qeveria Shqiptare dhe Ministria e Inovacionit dhe Teknologjine e Informacionit dhe Komunikimit tashme kane deklaruar dixhitalizimin e Shqiperise nepermjet zhvillimit te internetit me brez te gjere nje prioritet strategjik per zhvillimin e Shqiperise, sic tregohet qarte dhe nga dokumentat me poshte:

- Shqiperia duhet te dixhitalizohet- Sic parashtrohet dhe ne Strategjine Nder-Sektoriale per Shoqerine e Informacionit (Vendim i Keshillit te Ministrave Nr.59, date 21.02.2009) , mbyllja e hapësirës që ekziston në lidhje me nivelet e dixhitalizimit ndërmjet Europës dhe Shqipërisë është një kusht i detyrueshëm për të rritur konkurrueshmërinë në vend, sidomos duke qenë në mes të Europës. Sic pohohet ne Strategji, me nenshkrimin e SEE Agenda + ne Tetor 2007, Shqiperia ri-konfirmoi vullnetin dhe angazhimin e saj per te perparuar drejt botes dixhitale dhe per te sjelle objektivat e saj ne nje linje me vendet e Bashkimit European, sic eshte shprehur ne politiken kuader (qe njihet si i2010) per shoqerine e informacionit dhe mediat per periudhen deri ne vitin 2010. Ne strategji, aksesi me brez te gjere konsiderohet si guri themelor i zhvillimit ekonomik, me impakt te prekshem ne ekonomine e bazuar ne informacion dhe u parashikua se zhvillimi i infrastruktures per rrjetet e aksesit me vale te gjenerates se ardhshme duhet te kishte ndodhur gjate periudhes 2008-2009.

- *Se fundmi, ne Maj 2010, Keshilli i Ministrave ka adoptuar Dokumentin e Politikave per Komunikimet Elektronike. Politika tregon qarte se rritja e penetrimit te internetit me brez te gjere duhet te arrihet kryesisht nepermjet teknologjive te komunikimit me vale. Dhenia e autorizimeve 3G eshte nje hap madhor per te mundesuar realizimin e nje synimi te tille strategjik per vendin. Eshte e qarte se ndertimi i rrjeteve 3G duhet t'iu lihet lojtareve te tregut qe kane krijuar reputacion dhe eksperience, dhe qe kane treguar qe jane ne gjendje t'i ofrojne publikut sherbime te sofistikuar te komunikimeve elektronike.*

Gjithashtu, ne Dokumentin e Politikes theksohet fakti se nuk ka arsye per te vonuar hedhjen e mundshme ne treg te teknologjive te aksesit me brez te gjere si celulari 3G. Perkundrazi, kjo inkurajon perdorimin e cfaredo teknologjie qe do te sjelle nje variete me te gjere zgjedhesh, cilesi dhe cmimi ne treg.

Shqiperia momentalisht eshte vendi i fundit ne rajon qe jep te drejta per hyrje ne treg per spektrin 3G. Me poshte jepet nje pershkrim i shkurter i praktikes ekzistuese ne tregje te tjera rajonale, per te treguar me shembuj se sa vone eshte Shqiperia ne nderrmarrjen e ketyre hapave. Pra, eshte me teper se e nevojshme qe Shqiperia te rekuperoje kohen e humbur, duke dhene te gjitha autorizimet e hyrjes ne treg ne te njejten kohe.

Eksperienca e dhenies se licencave / autorizimeve 3G ne rajonin e Ballkanit:

- *Rumania dha licencat 3G ne periudhen Tetor 2004-Qershor 2006.*
- *Serbia dha licencat 3G gjate periudhes 2005-2006.*
- *Ish Republika Jugosllave e Maqedonise dha licencat 3G gjate periudhes 2007-2008.*
- *Mali i Zi dha licencat 3G ne vitin 2007.*
- *Turqia dha licencat 3G ne Dhjetor 2008.*
- *UMTS e evoluar ne HSPA, HSPA + tashme eshte nje alternative e besueshme per dhenien e aksesit me brez te gjere zonave/ popullsise rurale, si dhe atyre periferike shume me shpejt se propozimet per teknologji kabllore si DSL. Shtrirja e aksesit me brez te gjere ne te gjithe popullsine ne Shqiperi eshte nje synim madhor i politikes se Qeverise dhe qe do te kontribuojne ne zhvillimin e pergjithshem te vendit. Pa integrimin e rreth 50% te gjithe popullsise rezidente ne zonat e siperpermendura, ne Shqiperi nuk do te ekzistojne mundesite per nje zhvillim te shpejte e te qendrueshem. Ofrimi i aksesit ne internet me brez te gjere ne keto zona eshte nje domosdoshmeri kombetare dhe qe eshte njohur dhe nga vete Qeveria. Duke qene se vetem teknologjite e komunikimit me vale (wireless) kane mundesi te arrijne kete synim te politikes ne menyre eficente nga pikepamja e kosos, eshte teper e rendesishme te jepen te drejta per UMTS ne te njejten kohe per te gjithe lojtaret ne treg qe plotesojne kriteret baze per zhvillimin e rrjeteve te tilla, sepse kjo do te nxiste shtrirje me te shpejte te rrjeteve UMTS ne vend, neper te gjithe territorin gjeografik dhe per me teper me cmime te perballueshme nga te gjithe qytetaret per te sjelle penetrimin e internetit me brez te gjere tek individet, familjet dhe bizneset.*

UMTS eshte bere nje mundesi e parapelqyer ne mbare boten ne krahasim me teknologjite e tjera te komunikimit me vale si WiMAX. Ka nje disponueshmeri te gjere te pajisjeve fundore qe mbeshtesin 3G/HSPA (mbi 2000), nga rreth 215 prodhues te specializuar . 3G/HSPA eshte shtrire ne me shume se 300 rrjete ne 133 vende se bashku me pranine e HSPA+ (standard HSPA te evoluar) ne me shume se 35 vende. 545 milione abonente perdorin teknologjine UMTS ne mbare boten. Ne mendojme se Shqiperia duhet te ndjeke standartet e vendosura ne Europe dhe te ndaje eksperiencen me te mire me pjesen tjeter te tregjeve. Pajisjet fundore te klientit (per

shembull USB dongle) ofrohen se bashku me nderfaqe te lehta per t'u shfrytezuar nga perdoruesi (d.m.th lehtesi instalimi, aktivizim i lidhjes ne rrjet dhe perdorim).

Komenti i AKEP:

-Sherbimet kryesore qe pritet te ofrojne rrjetet UMTS jane:

- interneti me brez te gjere*
- videothirrjet*
- sherbimet multimediale*
- videokonferencat*
- TV*
- transmetime te dhenash ne pergjithesi*

Pyetja:

2- A do te behen sherbimet UMTS sherbime konsumi masiv ne treg? Neqoftese po, per cfare periudhe kohe?

A-

Ne pergjithesi nuk pritet te kemi ndryshim radikal ne treg, thjesht do te kemi permiresim te komunikimeve ekzistuese celulare duke u dhene perdoruesve shpejtesi me te madhe transferimi te dhenash dhe mundesine e aplikimeve te sherbimeve te reja te permenduar me lart.

Sherbimet UMTS kerkojne kohe te behen sherbime masive ne treg, pasi kjo eshte nje sfide e perballjes me sherbimet e reja te domosdoshme dhe planifikimin e rrjetit 3G

B-

Ka disa faktore qe ndikojne faktin e rritjes se konsumit per sherbimet UMTS. Ne rradhe te pare eshte kosto ne te cilen keto sherbime do t'u ofrohen perdoruesve fundore. Kjo kosto/cmim eshte rezultat i llogaritjeve te kostove qe kane operatoret per ofrimin e ketyre sherbimeve, ku pjesa me e madhe i perket 2 komponenteve:

- a) Investimi teknologjik per ndertimin e rrjetit 3G*
- b) Investimi per sigurimin e Autorizimit Individual (perdorimi i frekuencave)*

Ne praktike, investimi teknologjik per ndertimin e rrjetit eshte i paevitueshem dhe kompania jone e ka perfshire tashme kete investim ne Planin e Biznesit. Kosto e Autorizimit Individual (e cila eshte ende e papercaktuar) perben nje faktor te rendesishem per percaktimin e cmimit te perdoruesit fundor. Praktika europiane ka treguar qe sa me e larte te jete kjo kosto, aq me te larta jane cmimet e sherbimeve 3G per perdoruesit fundore, duke ngritur keshtu nje barriere per konsumin e ketyre sherbimeve.

Faktor tjetër është mundësia e publikut për të përfituar shërbimin e Internetit me mënyra të tjera alternative. Në tregun shqiptar ekzistojnë ISP që ofrojnë këto shërbime por fatkeqesisht kanë një mbulim shumë të limituar dhe kryesisht në qendrat e qyteteve më të mëdha urbane. Për shkak të teknologjisë dhe mënyrës së ndërtimit të rrjetit, përdorimi i frekuencave 3G nga operatorët celulare, pa dyshim që ndikon pozitivisht në rritjen progresive të përdoruesve të këtyre shërbimeve.

C-

Rrjetet UMTS janë përdorur për herë të parë në vitin 2001. Për këtë arsye, shërbimet UMTS janë kthyer tashmë në një shërbim konsumi masiv në treg, pasi kërkesa për shërbime të dhenash celulare të një shpejtësie të lartë po rritet. Përmirësimet periodike të rrjeteve UMTS (p.sh rritja e shpejtësisë së transmetimit të të dhënave nga përdorimi i HSDPA, HSPA+, etj) po i ofrojnë përdoruesit fundor një eksperiencë të re dhe të përmirësuar. Sipas GSA-së, "Teknologjia 3G/WCDMA është tanimë e disponueshme në 347 rrjete në 144 vende të botes, ndërkohe që evoluimi i saj i parë , protokollit HSPA është implementuar dhe komercializuar në 341 rrjete, dmth. nga më shumë se 98% e operatorëve WCDMA". Gjithashtu, disa operatorë celulare, përfshirë operatorin lider të Japonisë, NTT DoCoMo-në, kanë deklaruar se po përshejtojnë planet për të ndërprerë përdorimin e rrjeteve 2G në vitin 2011..Aktualisht, është e vështirë që të gjenden vetëm pajisje terminale GSM, pasi pjesa më e madhe e pajisjeve terminale kanë të inkuorporuar marrë UMTS, gjithashtu.

Evoluimi i rrjeteve UMTS drejt teknologjive HSPA/HSPA+ në përfitim të përdoruesve celulare mund të pritet shumë shpejt edhe në Shqipëri, duke qenë se, si rregull, pajisjet e rrjetit 3G mund të përshtaten edhe me teknologjinë HSPA/HSPA+ dhe disponueshmeria në rritje e pajisjeve që pranojnë teknologjinë HSPA/HSPA+ do të nxirë një evoluim të tillë.

Kohezgjatja e një rrjeti UMTS dhe shërbimeve përkatëse nuk mund të vlerësohet qartë, pasi teknologjia UMTS është ende në zhvillim e sipër dhe askush nuk mund të parashikojë ciklin e jetës së kësaj teknologjie.

Në këtë kontekst, duhet të kemi parasysh që rrjetet GSM u shfaqën në vitin 1987 dhe vazhdojnë të përdoren dendur edhe sot e kësaj dite.

D-

UMTS ofron një strukturë më të pasur shërbimesh për abonentët. Këto kryesisht përfshijnë lidhje më shpejtësi të lartë/bandë të gjere (high speed connection), mbulim cilesor, siguri të përmirësuar IT dhe aftësi për të përfituar shërbime sipas vendodhjes.

Sipas standarteve dhe eksperiencës të krijuar në Europë, si dhe nevojave dhe domosdoshmerive të ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare, përveç aksesit në internet me brez të gjere dhe shpejtësi të lartë, shërbimet të cilat kanë potencial për të garantuar suksesin e UMTS janë :

Sherbime me potencial të lartë

Navigimi në internet (web browsing)

Aksesi me brez të gjere në telefonin celular dhe kompjuter (mobile broadband/pc connectivity)

Gazeta on-line

Lojra, aplikacione, widgets

Sherbime me potencial mesatar dhe të ulët

Audio sipas kërkesës/muzikë (video and music on demand)

Klipe video, shetitje virtuale

Blerje interactive

Vendodhje personale (personal location)

Mobile office

Video telefoni

Sherbime transmetimi sipas vendndodhjes (location based broadcasting services)

Biblioteke on-line, trajnime (shkolla virtuale)

Rrjetet GSM ne Shqiperi kane mbulim te konsiderueshem, pra 3G/HSPA ne fazat fillestare do te perdoren me se shumti per sherbime te dhenash (data services), duke plotesuar nevojën per akses ne internet me brez te gjere se bashku me mundesine per ofrim te sherbimit ne levizje. Eksperienca europiane tregon se rrjetet 3G/HSPA gjenerojne afersisht 90% te trafikut te tyre nga sherbimet e te dhenave, dhe e njejta situatë pritet te krijohet edhe ne Shqiperi.

Garancia per suksesin e rrjeteve 3G/HSPA eshte shkalla e zhvillimit dhe cilesia e teknologjise ne te cilen mbeshteten keto sherbime. Kjo eshte testuar dhe zbatuar gjeresisht ne Europe, ku ka patur rritje te konsiderueshme ne perdorimin e te dhenave permes UMTS.

Shumica e ketyre sherbimeve i drejtohen konsumatoreve dhe do te ofrohen permes lidhjes nga celulari dhe kompjuteri. Sic sugjerohet nga eksperienca e BE, fakti nese UMTS do te behet apo jo nje sherbim per konsumin masiv varet nga nje sere faktoresh ne nderveprim dhe ngushtesisht te lidhur me njeri-tjetrin, te ndare ne dy kategori kryesore:

- 1) *Faktore qe kane lidhje me oferten (supply side factors); dhe*
- 2) *Faktore qe kane lidhje me kerkesen (demand side factors).*

- 1) *Faktore qe kane lidhje me oferten : kane te bejne me disponueshmerine e rrjeteve dhe konkurrencen. Sic e kemi shprehur dhe me siper ne document, dhenia ne te njejten kohe e kater autorizimeve te disponueshme 3G me cmime te drejta, do te lejoje dhe do te nxise te gjithë operatorët celularë te konkurrojnë ne ndertimin e rrjeteve dhe ne shtrirjen e 3G me shpejtesi te konsiderueshme. Ne kete kontekst, krijimi nga ana e Qeverise i nje kuadri rregullator per ndertimin e nje rrjeti themelor me fiber ne Shqiperi do te ndihmonte shtrirjen e rrjeteve 3G.*

Elemente te tjere te ofertes kane te bejne me disponueshmerine e kompjuterave dhe pajisjeve te tjera IT me cmime te perballueshme per publikun, ceshtje qe duhet te trajtohen nga Qeveria dhe nga aktoret perkates te industrise se Teknologjise se Informacionit.

- 2) *Faktore qe kane lidhje me kerkesen. Sipas studimeve me te fundit ne BE, nje tjetër faktor shume i rendesishem per percaktimin nese sherbimet UMTS ne treg do te behen sherbime masive jane masat nxitese te kerkeses qe Qeveria e nje vendi duhet te marre per te nxitur institucionet qeveritare, aktoret ekonomike dhe publikun per te perdorur keto sherbime te reja. Pra, permasa dhe shpejtesia e masave per stimulimin e kerkeses per sherbime te tilla qe Qeveria Shqiptare do te zbatoje, si p.sh. e-health, e-economy, e-commerce, etj, do te ndikojne ne faktin nese dhe kur sherbimet UMTS, sherbimet te levizshme me brez te gjere do te behen sherbime masive ne Shqiperi. Kjo per faktin se rritja e penetrimit te sherbimeve te tilla varet nga shkalla e dixhitalizimit te ekonomise dhe shkembimeve ekonomike dhe sociale ne pergjithesi.*

Pra, nese te gjithë faktoret e mesiper nderveprojne sic duhet, ne mendojme se ka mundesi te mira qe sherbimet celulare me brez te gjere te rriten gradualisht ne vitet ne vijim.

Ne besojme fuqimisht se Qeveria duhet te veproje me vendosmeri dhe te jape te gjitha autorizimet ne te njejten kohe, ne menyre qe te arrije nivelet me te larta te penetrimit te internetit me brez te gjere ne vend, ne sa me pak kohe. Ne rast se AKEP dhe Qeveria do te kufizojne numrin e autorizimeve, kjo do te vonoje se tepermi rritjen e nivelit te penetrimit te sherbimit te internetit me brez te gjere. Ne rast te dhenies te menjehershme te autorizimeve pa kufizime, konkurrenca me e larte ne treg do te sjelle nxitje me te madhe per te siguruar mbulim me te gjere gjeografik dhe te popullates sa me shpejt te jete e mundur. Gjithashtu, prania me e madhe e

lojtareve me rrjete 3G ne treg do te sjelle perfitime te konsiderueshme per konkurrencen dhe konsumatorin. Konkurrenca me e larte do te sjelle cmime me te uleta dhe disponueshmeri me te larte te shumllojshmerise se sherbimeve me baze 3G. Ne fakt, kjo ka qene filozofia e AKEP dhe e Qeverise ne liberalizimin e tregut GSM , duke rritur numrin e lojtareve. Kufizimi i hyrjes ne treg te disa lojtareve 3G njekohesisht do te ishte nje hap teresisht kontradiktor.

Komenti i AKEP:

Sherbime konsumi masiv ne treg mund te behen interneti dhe ato multimediale. Koha e parashikuar se kur ata mund te jene masivisht te perdorur, sipas komenteve varet nga disa faktore, si psh, menyra e dhenies se autorizimeve (ne kohe dhe ne vlere), penetrimi etj keshtu qe nuk ka ndonje periudhe te sakte.

Pyetja:

3- Cfare kushtesh do te jene optimale per akses ne keto sherbime referuar territorit-gjeografise?

A-

Me poshte ne menyre tabelare jepen te dhenat e aksesit per sherbimet kryesore referuar llojit te mbullimit.

Lloji i mbullimit (On Street)	AMR 12.2	CS Video 64	PS 64	PS 128	PS 384
PCPICH RSCP Outdoor	-104 dBm	-101 dBm	-101 dBm	-96 dBm	-91 dBm
PCPICH RSCP In-car	-98 dBm	-95 dBm	-95 dBm	-90 dBm	-85 dBm
PCPICH RSCP In-Building Residential	-90 dBm	-87 dBm	-87 dBm	-82 dBm	-77 dBm
PCPICH RSCP In-Building Commercial	-84 dBm	-81 dBm	-81 dBm	-76 dBm	-71 dBm
PCPICH RSCP In-Building High Dense Urban	-81 dBm	-78 dBm	-78 dBm	-73 dBm	-68 dBm
PCPICH Ec/NO (all types) (internal targets)	-12 dB	-11 dB	-11 dB	-10 dB	-9 dB

B-

Mbulimi me sinjal i popullates ne nje kohe sa me te shpejte, eshte faktori me i rendesishem per ofrimin e aksesit ndaj ketyre sherbimeve. Aktualisht, vetem operatoret e licensuar te telefonise se levizshme kane mundesine qe t'i bashkangjisin rrjetit GSM edhe pajisjet e rrjetit 3G ne nje kohe optimale.

C-

Perdoruesit fundore kane nevoje per dy menyra per te patur akses ne sherbimet UMTS:

- a) pasjen e shkalles se duhur te mbulimit dhe cilesise ne territorin qe ata jetojne perdite dhe*
- b) pasjen e tarifave relativisht te ulta ne menyre qe te shijojne sherbimet e pasura qe ofrojne rrjetet UMTS.*

Ne keto kushte, ne Shqiperi duhet te kushtohet vemendje e vecante ne menyre qe te kemi nje mbulim shume te mire radio per rrjetet UMTS qe do te implementohen, dhe pervec kesaj, operatoret shqiptare duhet te pergendrohen ne ofrimin e sherbimeve UMTS me cmime te favorshme per shumicen e popullsise. Si rrjedhoje, sherbimet UMTS duhet te konsiderohen per implementim edhe ne brezin e frekuencave 900 MHz dhe 1800 MHz, pervec atyre ne 2100 MHz.

D-

Kur i referohemi kushteve optimale gjeografike, pergjigjia vjen direkt nga teoria e perhapjes se sinjalit radio qe do te thote : terren i sheshte, qytete dhe fshatra te mire planifikuara do te lehtesonin shtrirjen e rrjetit UMTS dhe do te ofronin akses te lehte ne sherbimet. Nje tjetër faktor i rëndësishëm është disponueshmëria e rrjeteve themelore me fiber ose ofruesve të këtyre rrjeteve. Kushtet teorike si me sipër nuk ekzistojnë në Shqipëri, e cila karakterizohet nga një terren malor dhe qytete e fshatra të pazhvilluara sa i takon urbanizimit. Po ashtu mungojnë rrjetet themelore të fibrit optik me shtrirje kombëtare.

Duke qenë se 3G/HSPA është një teknologji e komunikimit me vlerë (wireless), pritet një hedhje e shpejtë në treg (aksesueshmëri nga konsumatori) . Në do të shfrytëzohet aty ku është e mundur infrastrukturen të ekzistueshme për të ofruar sherbimet UMTS me shpejtësi. Sidoqoftë, si pasojë e frekuencave më të larta kundrejt spektrit GSM, do të haset planifikim radio me vështirësi në zonat urbane me dendësi të madhe dhe ndërtesa të larta dhe zonat rurale me terren të ashpër, që do të thotë se do të rritet në mënyrë të ndjeshme numri i stacioneve, që përkeqësohet në mënyrë të shpejtë investime për biznesin.

Gjithashtu, duke qenë se shtrirja e UMTS nënkupton rritje të konsiderueshme në përdorimin e të dhënave, nevoja për zgjidhje të qëndrueshme në rrjetin e transmetimit bëhet e domosdoshme. Pra, lehtësimi nga ana e Qeverisë i ndërtimit të rrjetit themelor me fiber optik dhe/ose lehtësimi i të drejtave për të ndërtuar këto rrjete (rights of way), pra mënyra se si kjo do të mundësohet përbejnë faktorë të rëndësishëm që përcaktojnë suksesin e shtrirjes së infrastrukturës 3G.

Komenti i AKEP:

Mbulimi me sinjal, penetrimi, shpejtësia e mbulimit me sinjal dhe tarifat janë kushtet kryesore për të mundësuar aksesin masiv të sherbimeve që ofron UMTS.

Pyetja:

4- Cfare roli do te luajne UMTS ne konvergjencen e telekomunikimit/kompjuterit/radio-televizionit dhe fiks/mobile.

A-

Me ndihmen e rrjeteve UMTS, telekomunikacioni do të jetë në gjendje të konkurrojë me ofruesit fiks me brez të gjërë dhe transmetimet Radio TV, sherbime që mund të përdoren në telefon me cilësi shumë të lartë

B-

Pa dyshim qe efekti me i dukshem do te jete ne rritjen e penetrimit te sherbimit te Internetit per shkak te mbulimit te shpejte me sinjal te popullates dhe konvergjim te sherbimeve te kesaj natyre. Impakti fillestar do te jete i ulet ne konvergjimin e sherbimeve te telekomunikacionit.

C-

Rrjeti UMTS mund te perdoret si nje alternative kundrejt rrjeteve tradicionale kabllore DSL (ADSL, etj). Kjo ka nje rendesi te madhe per Shqiperine per shkak te disponueshmerise shume te kufizuar te telefonise fikse: norma e penetrimit te telefonise fikse ishte rreth 11% ne vitin 2009. Gjithashtu, ekziston nje norme penetrimi shume e ulet edhe e rrjeteve fikse me brez te gjere, me vetem 80,000 lidhje ne brez te gjere ne vitin 2009. Si rrjedhoje , sherbimet celulare me brez te gjere te ofruara nepermjet rrjeteve UMTS mund te luajne nje rol kyc ne rritjen e aksesit te bizneseve dhe qytetareve shqiptare ne sherbimet me brez te gjere.

Pervec kesaj, sherbimet UMTS perfshijne hapin e pare drejt zhvillimit te teknologjive te brezit te ardhshem HSPA/HSPA+ dhe ato te mevonshme LTE. Ne te ardhmen, UMTS mund te ofrojne drejtimin e kundert per sherbime te ardhshme interaktive, Mobile-TV (p.sh, permes integrimin me teknologjite broadcast, sic jane rrjetet DVB-H,DVB-S). Te gjitha keto aplikime mund te sherbehen nga nje rrjet i perbashket qendror, duke cuar keshtu drejt konvergjences fiks-celular, duke perdorur platformat IMS.

Konvergjenca e telekomunikimeve, kompjuterit dhe industrive konsumatore elektronike (CE) po con ne lindjen e nje klase te re aparatesh celulare.Zhvillimi i telefonave celulare po i kthen celularet 3G ne platforma me te fuqishme llogaritese dhe CE (konsumatore elektronike). Per shembull, aparatet e rinje celulare kane te perfshire funksione te paneleve te komandimit per lojra, portofolin elektronik, lexues barkodesh, lexues muzike, aparat mates glukoze dhe shume aplikime te tjera.

Ne ambientet shtepiace, router-at 3G u japin mundesi operatoreve te ofrojne sherbime me brez te gjere me performace te larte perdoruesve qe jane jashte mundesive per te marre oferta tradicionale DSL dhe me kabell.Teknologjite e reja per mbulim te brendshem, si femtocell te perdorura ne rrjetin 3G, jane gjithashtu pjese e konvergjences fiks-celular.

D-

UMTS tashme ka rezultuar i suksesshem ne integrimin e kompjuterit personal me telekomunikacionet nepermjet USB dongles. Ne presim qe kjo te jete rrjeti kryesor per arritjen ne shkalle te konsiderueshme konvergjenca ne periudhen afat shkurter deri afat mesme.

UMTS i lejon konsumatoreve te aksesojne potencialin transformues te internetit nepermjet pajisjeve te tyre celulare-nga telefonat e thjeshte deri ne ato me te sofistikuar iPhones, Blackberry e deri te netbook/laptope.

UTMS ka benefitin shtese te mundesise per ofrim te sherbimit ne levizje, ne arritjen e konvergjences ndermjet botes se kompjuterit dhe telekomunikacionit.

Rrjetet 3G/HSPA mbeshtetin dhenien e sherbimeve me permbajtje te ndryshme per perdoruesit fundore permes RAB (radio access bearer) te ndryshme. Sherbimet Video dhe audio mund te transferohen lehtesisht ne rrjetin 3G/HSPA nepermjet metodes "streaming", prandaj kanalet TV &Radio duhet te konsiderohen pjese e paketes se sherbimit.

Standartet e performances te ofrimit te sherbimeve permes UMTS kane arritur performancen e ofruar nga linjat fikse, pra ekperienca e perdoruesit fundor konsiderohet te jete e krahasueshme.

*Tendenca me e fundit per konvergjencen nga fiksi ne celular eshte koncepti **femto cell**, ku klientet i marrin sherbimet 3G/HSPA ne shtepi ose zyre permes nje kombinimi te lidhjeve fikse te rrjetit te transmetimit dhe aksesit te komunikimit me vale (wireless).*

Komenti i AKEP:

Teknologjia e perdorur ne keto breza ka bere te mundur konvergjencen e sherbimeve si telefoni, TV, PC, Data etj dhe zhvillimet e pritshme do te rrisin performancen e ketyre sherbimeve. Madje konvergjenca eshte nje nga qellimet e futjes te ketyre zbatimeve te reja.

Pyetja:

5- Cfare pasojash do te kete futja e internet protokollit ne rrjetet e UMTS, ne interkoneksion, adresa, emertime, akses te kushtezuar etj?

A-

Meqe rrjetet e reja jane plotesisht ne perputhje me teknologjine IP dhe mbeshtesin rrjetet 2G dhe 3G, nuk do te kete ndonje efekt ne interkoneksion dhe adresa. Ndersa per aksesin dhe planifikimin e rrjetit 3G, do te nevojiten investime te konsiderueshme shtese ne rrjet shtese aksesit sic jane nyjet- b (ne stacionet baze 3G) dhe RNC, i cili eshte kontrolluesi i te gjitha elementeve te rrjetit e nyjeve –b.

B-

Kryesisht UMTS eshte teknologji RAN (Radio Access Network), e cila eshte e pavarur nga CORE: i njeiti Core mund te sherbeje njekohesisht si 2G dhe 3G RAN. Ne anen tjeter UMTS nuk eshte e bazuar ne IP dhe ndryshimet teknologjike me te medha kryesisht priten ne prezantimin fillestar te LTE. Praktikisht, evolucioni i CORE ne IMS nuk ndodh me prezantimin e UMTS, sepse kjo nuk eshte e nevojshme. Vendimi ne lidhje me zgjedhjen e teknologjise CORE ngelet pa dyshim ne dore te operatorit.

Ne Europe, teknologjia 3G u integrua ne menyre te natyrshme me rrjetet GSM, pa demtuar aktivitetin dhe eksperiencen e konsumatorit te rrjeteve GSM.

C-

Drejt evoluimit per nje all-IP RAN, arkitektura e rrjetit duhet te mbeshtese tipet e shumta radio (multiradio) ku secili element radio ka atributet dhe kerkesat e tij te transmetimit. Cdo rrjet backhaul all-IP RAN duhet te adresoje zhvillimet me te fundit radio, ku lidhja e rrjetit eshte nje nderfaqe IP e paster. Nje zgjidhje all-IP RAN backhaul duhet te perfshije gjithashtu nje metode per migrimin e llojeve ekzistuese apo tradicionale te transportit ne nje infrastrukture pakete. Duke perdorur lidhjet Ethernet me IP apo MPLS, te gjitha sherbimet do te transmetohen sic duhet nga stacioni ne qender.

Disa karakteristika te rendesishme ne rastin e all-IP RAN do te perfshijne : Shkallzueshmerine, Gjeresine e Brezitet, Redundanc-en, Disponueshmerine e Larte, Monitorimin e Performances dhe SLA-se, Cilesine e Sherbimit, Sinkronizimin, Rrugezimin dhe Sigurine e Layer 3.

Migrimi tek nje all-IP/Carrier Ethernet RAN do te jete nje proces shumevjecar per operatoret qe kane kryesisht rrjetet 2G dhe 2.5G dhe evolujne drejt rrjeteve UMTS. Ne fund, rrjetet celulare do te shkaterrojne teknologjite backhaul ne favor te sherbimeve te bazuara ne teknologjine IP qe kalojne nga stacioni baze deri tek qendra e rrjetit.

D-

Duke patur parasysh rritjen e shpejte te perdorimit te standarteve IP dhe konvergjencen e ardhshme te telekomunikacionit me sherbimet IP/IT, zbatimi i transportit IP ne rrjetin celular praktikisht eshte bere i detyrueshem. Ekperiencat europiane te koheve te fundit tregojne se transporti me baze IP eshte bere i zakonshem ne rrjetet fikse per shkak te perfitimeve te konsiderueshme qe i jep operatoreve sa i takon efikasitetit operacional. Ne kete menyre ka vertetuar aftesine e saj per te mbeshtetur me mire nje arkitekture funksionale dhe ne te njejten kohe te shperndare, se bashku me nje topologji rrjeti me fleksible se sa praktikohet per rrjetet ATM.

Thjeshtesia dhe fleksibiliteti i transportit IP, se bashku me perdorimin e saj mbareboteror u gjeten se ishin aset te vlefshme qe kjo te merrej ne konsiderate dhe per rrjetet 3G/HSPA. (IP u prezantua me teknologjine GPRS/EDGE per te optimizuar performancen e rrjeteve GSM gjate perdorimit te tyre se bashku me sherbimet e ofruara permes rrjeteve me komutim pakete)>

*Se bashku me shtresat e tjera te larta te protokollit, si Protokollet e Kontrollit te Transmetimit (TCPs), IP perben nje mekanizem te thjeshte dhe fleksibel te shperndarjes se te dhenave qe mund te transmetoje cfaredo lloj informacioni ndermjet pajisjeve. **D** eshte e gatshme te zbatoje nderfaqet me baze IP ne lu-CS, lu-PS, lur dhe lub, duke ofruar ne Shqiperi nje rrjet evolutiv dhe qe i reziston kohes (future proof networks). Kjo behet per te ofruar perfitime te konsiderueshme per klientet sa i takon gjerese se brezit & zvogelimit te voneses (latency) te ofruar ne sherbimet me komutim pakete. Adresimi i nyjeve 3G/HSPA do te perputhet me standartet IP, pra ka nje shtrese IP nga fillimi ne fund, qe mbeshtet sherbimet e internetit me brez te gjere.*

Komenti i AKEP:

Aplikimi i Teknologjise IP do te kerkoje investime per rrjetet 2G. Per operatoret qe kane implementuar teknologji te reja ne ndertimin e rrjeteve te tyre investimet dhe nevojat per ndryshime ne konfigurime do te jene me te vogla.

Pyetja:

6- AKEP fton sipermarresit te japin mendime mbi zhvillimet ne arkitekturen e rrjetit qe do te jete e nevojshme per te mbeshtetur nderveprimin eficient te UMTS me internetin ose ndryshe ne pergjithesi me rrjetet e bazuara ne teknologjine IP.

A-

S'ka koment

B-

Duke qene se UMTS eshte vertetuar te jete kryesisht teknologji e transportit te te dhenave, profili i trafikut eshte i ndryshem nga telekomunikacioni tradicional (voice). Kjo do te influencoje kryesisht teknologjine e transportit. Trafiku i zerit do te vazhdoje te serviret nga pjesa e qarkut, per dy arsye: terminalat jane ndertuar ne varesi te ketyre parimeve, ndersa ne rast te VoHSPA kjo do te kerkoje kliente VoIP ne terminale. Nga pikepamja e rrjetit, do te kerkoje zvogelim te kohes se pritjes ne rrjet (leshimet aktuale duhet te zgjasin kohën e pritjes ne menyre qe te siguroje cilesi te mire te zerit). Persa i perket konvergences se rrjetit mobil dhe fiks, duke u bazuar ne CORE te perbashket, kjo do te mundesohet ne te ardhmen ne sate te teknologjise IMS.

C-

Lidhja me internetin perben nje aftesi te qenesishme te rrjeteve UMTS, pasi ajo mund te mbeshtetet nga arkitektura e saj e standartizuar- permes lidhjes GGSN me rene e internetit. Nepermjet rrjeteve UMTS, perdoruesit celulare kane mundesi te marrin sherbime celulare te te dhenave, si Interneti, nderkohe qe me futjen e teknologjise HSPA, sherbimet celulare te te dhenave mund te ofrohen me shpejtesi akoma me te larte (DL: 1.8/3.6/7.2/14.4 Mbps dhe UL:1.4/5.76 Mbps).

Gjithashtu, nga kendeveshtrimi teknologjik, megjithese zbatimet perkatese komerciale nuk jane gjeresisht te disponueshme, UMTS mund te kombinohet me cfaredolloj teknologjie IP dhe ne rrjetet e zakonshme me baze paketash ne nje sere menyrash, ne shtresa te ndryshme te arkitektures se rrjetit, me DVB-H/SH per sherbime multimediale interaktive, nderkohe qe lidhja me nje stacion femtocell bazohet ne lidhjet xDSL,etj. Ne secilin nga shembujt e lartpermendur te interkoneksionit ne rrjetet UMTS me rrjetet e tjera te bazuara ne teknologjine IP apo ne paketa, pikat e interkoneksionit, konfigurimi/modifikimet e rrjetit dhe arkitektura e sistemeve UMTS jane te ndryshme, dhe objekt i kerkimeve te metejshme, dhe sigurisht qe ekzistenca e rrjetit tjeter IP/Pakete eshte nje kusht paraprak.

D-

Evolucioni i standarteve te ardhshme 3G/HSPA perputhet me konceptin e arkitektures se sheshte me prezantimin e Direct Tunnel ose dhe I-HSPA, duke nxitur me tej lidhjen IP drejt ofruesit te deshiruar te sherbimeve/permbajtjes.

Nga perspektiva e rrjetit komutues, teknologjia me baze IMS hap boten e sherbimeve me baze IP per perdorim celular, duke integruar ne harmoni boten celulare dhe boten e Internetit dhe duke ofruar mekanizma te sofistikuara te sherbimit, qe do te perdoren ne kontekstin e komunikimeve celulare. Arkitektura e synuar e IMS eshte ndertuar me standarte qe bazohen ne konceptet e meposhteme:

- *Lidhje IP*
- *Pavaresi nga Aksesi*
- *Projektim rrjeti me shtresa te ndryshme*
- *Cilesi e Sherbimit*
- *Politika e Kontrollit IP*
- *Komunikim i Sigurte*
- *Tarifim*
- *Mundesia per roaming*
- *Nderveprim me rrjete te tjera*

Standarti IMS sherben per te mbeshtetur aplikacionet per komunikim abonent me abonent, te cilat duhet domosdoshmerisht te bazohen ne mundesine per realizimin e ketij komunikimi ne lidhjen IP. Duke gene se Ipv6 ka sjelle shume permiresime, ajo mbeshtetet nga standarti IMS, por nga ana praktike Ipv4 mund te perdoret si faze fillimi per rrjetet e komutimit me baze IMS.

Komenti i AKEP-

Zhvillimi i arkitektures se rrjetit do te bazohet ne zhvillimet e HSPA, DVB-H/SH per sherbimet multimediale dhe teknologjise IMS ne pergjithesi.

Pyetja:

7- A do te kete pasoja kjo ne ekonomi, konkurrence dhe ne termat rregullatore?

A-

S'ka koment

B-

Besojme se ofrimi i sherbimeve 3G do te kete pasoja te konsiderueshme ne ekonomi, si te dukshme edhe te padukshme). Duke rritur aksesin ne sherbimet e Internetit, pa dyshim do te rritet eficenca e komunikimit si per konsumatorët individuale, ashtu edhe te biznesit, duke ndikuar ne rritje te cilesise te jeteses. Po ashtu, rritja e perdorimit te kesaj game sherbimesh do te sjelle me teper te ardhura ne buxhetin e shtetit.

Fakti qe AKEP ka vendosur ne dispozicion 4 breza frekuencash e per rrjedhoje 4 operatore qe do te hedhin keto sherbime ne treg, eshte tregues i qarte se do te jete nje treg konkurrues. Persa i perket anes rregullatore, mendojme se sherbimet 3G do te rregullohen natyrshem ne kohe ashtu si edhe per sherbimet GSM.

C-

Sic pranohet edhe nga Komisioni European dhe autoritetet e tjera nderkombetare, disponueshmeria e madhe e sherbimeve te perballueshme me brez te gjere eshte nje nxites kyc i zhvillimit ekonomik dhe social ne cdo vend. Sic eshte theksuar dhe me lart, ne rastin e Shqiperise, sherbimet celular me brez te gjere mund te luajne nje rol te rendesishem, duke patur parasysh disponueshmerine e kufizuar te sherbimeve me brez te gjere DSL. Keshtu qe, eshte shume e rendesishme qe AKEP te veproje sa me shpejt te jete e mundur qe te ofroje autorizimet UMTS, ne menyre qe Shqiperia te mos ngele pas vendeve te tjera ne zhvillimin e sherbimeve me brez te gjere.

Ne besojme se do te kete nje kerkese te madhe per spektrin UMTS, me kusht qe procesi i dhenies se autorizimeve te marre ne konsiderate te gjitha kerkesat teknike te ofruesve te mundshem dhe qe autorizimet te ofrohen ne cmime te perballueshme, te cilat reflektojne kostot shume te medha te metejshme per ndertimin e rrjeteve UMTS.

Tregu Shqiptar celular eshte tashme shume konkurrues, por ne besojme se ofrimi i sherbimeve UMTS nga operatoret do te promovojë edhe me shume konkurrencen duke zgjeruar mundesine e sherbimeve qe u ofrohen abonentëve. Ne presim qe paketat e sherbimeve me brez te gjere do te ofrohen me cmime terheqese dhe do te merren gjeresisht nga perdoruesit e sherbimeve celulare ne Shqiperi.

D-

Ekonomite e shkalles mund te arrihen me migrimin e rrjeteve celulare drejt konceptit "All IP ". Konkurrenca ne Shqiperi mund te nxitet me tej per shkak te shtrirjes se infrastruktures IP efektive nga pikepamja e kostos nga shume lloje ofruesish te sherbimeve dhe permbajtjes, duke dhene nje variacion te gjere te ofrimit te sherbimit, me cmime te mira pakice. Pervec ofrimit te nje mjeti te nevojshem per zhvillim ekonomik, komunikimi me vale (wireless) luan nje rol te rendesishem ne arritjen e aksesit gjitheperfishires dhe mbylljen e hapësirave dixhitale. Ato mund te sjellin e-health, e-learning, e-government dhe sherbime te tjera publike, mund te mbeshtesin sherbime dhe media me cilesi te larte.

Integrimi i plote i IP ne teknologjine UMTS mund te krijojë parakushtet teknologjike per nje mjedis biznesi plotesisht konvergjuës (shiko pyetjen 4 me siper). Pavaresisht kesaj, evoluimi i aspekteve rregullatore i te gjithe mjedisit te biznesit (Transmetimet Radio TV (Broadcasting),

Telekomunikacionet (Telecoms), Perdorimi i Kompjuterit Personal (Personal Computing), Internet) do te duhet te ndodhin ne menyre qe te mundesohet konvergjence e plote. Arritja de facto e konvergjences teknologjike nuk do te thote ne asnje menyre se aktivitetet efikase te biznesit qe operojne ne nje mjedis teper te rregulluar do te konvergjoje menjehere, duke qene se nje mjedis i tille duhet te jete nje mjedis qe mundeson konvergjence. Pra, eshte detyre e AKEP dhe Qeverise Shqiptare te krijojne mjedisin e duhur legjislativ dhe rregullator per te mundesuar konvergjence te komunikimeve elektronike dhe transmetimeve Radio-TV, ne menyre qe te arrihen efekte positive per ekonomine, per konsumatorin dhe konkurrencen.

Komenti i AKEP:

Po, do te kete influence ne ekonomine e vendit dhe ne konkurrencen ne treg. Duket se operatorin ekzistues e shohin me optimizem futjen e 3G, qofte ne rritjen e konkurrences ashtu edhe ne ndikimin ne ekonomine e vendit.

Pyetja:

8- AKEP fton pjesemarrjesit te bejne komente mbi kerkesat per akses ne sherbimet "online" dhe mbi pozicionin e GSM ne lidhje me UMTS ne kete fushe.

A-

Pervec shpejtesise se internetit dhe kryerjes se telefonatave me video shumica e sherbimeve qe do te ofrohen nga rrjetet UMTS do te jene te njejta me sherbimet aktuale te ofruara nga 2G. Ne besojme qe sherbimet celulare UMTS ne shendetesi, siguri, telemetri, survejimi me video do te cojne sherbimet publike nje hap me perpara.

B-

Bazuar ne eksperiencen e tregjeve europiane, si edhe ne evolucionin teknologjik, eshte evident fakti se teknologjia UMTS eshte nje evolucion (rritje) e natyrshme e teknologjise GSM, duke rritur gamen e sherbimeve te ofruara perdoruesve fundore. Aktualisht, ku te ardhurat nga sherbimet klasike te telekomunikacionit, per shkak edhe te konkurrences jane ne rnie te vazhdueshme, ofrimi i sherbimeve 3G ju mundeson operatorëve te telefonise se levizshme mbijetesën ne treg.

C-

Persa i perket sherbimeve online si e-government, e-commerce, e-banking, te cilave Qeveria Shqiptare po u jep prioritet te larte, ne mund te themi se rrjetet UMTS do te krijojne infrastrukturen me te mire te komunikimeve per zhvillimin e ketyre sherbimeve.

UMTS ofron shpejtesi te dhenash qe jane me te larta se ato te ofruara nga GSM/GPRS/EDGE. Pervec kesaj futja e HSPA/HSPA+ mund te permiresoje ndjeshem shpejtesin e transmetimit te te dhenave qe ofrohen aktualisht.

Si UMTS ashtu dhe GSM i perkasin se njejtës familje te standarteve (3GPP). Nderveprimi midis ketyre dy teknologjive garantohet permes specifikimeve dhe eshte i implementuar nga prodhuesit e pajisjeve, dhe gjithashtu mbeshtetet nga aparatet ekzistuese. Ne praktike, menyra me e zakonshme per tu arritur kjo, eshte permes handover-ave te Teknologjise te Aksesit Inter-Radio (IRAT).

Persa i perket tregjeve te tjere, shperndarja e UMTS fillon ne zona urbane qe shfaqin kerkese te larte trafiku (GSM), keshtu qe rrjeti UMTS te shkarkoje trafik thirrjesh / te dhenash nga rrjeti GSM ndersa ofron, ne te njejten kohe, sherbime te reja 3G terheqese (p.sh, videotelefoni, lundrim me te shpejte ne internet, etj).

D-

GSM mbeshtet sherbimet me komutim pakete nepermjet rrjeteve te mbivendosura GPRS/EDGE. Me tendencen e sotme te perdorimit te gjere te rrjeteve sociale dhe e-commerce ose sherbime te ngjashme, perdorimi i burimeve te rrjetit me komutim pakete ka treguar rritje te dukshme ne rrjet me nje performance gjithesesi te mire. UMTS do te ofroje shpejtesi me te madhe ngarkim shkarkim, si dhe latency (vonesa) me te vogla, te cilat se bashku krijojne experience superiore per perdoruesin.

Sidoqofte eshte e vlefshme te permendet se rrjetet 2G nuk i perputhen me aplikacionet e ndryshme qe kerkojne akses me brez te gjere qe i jepen perdoruesit permes internetit. Aplikacionet qe kerkojne brez te gjere per t'u perdorur adresohen apo mbeshteten vetem me ane te teknikave te permiresimit te gjeresise se brezit HSPA. Kjo per shkak te faktit se ne shume raste, edhe R99 RAB (radio access bearers) mund te konsiderohen se ofrojne per klientet sherbim me cilesi te dobet.

Zbatimi tipik i rrjeteve 3G udhëhiqet nga parimi qe nese nuk ka mbulim ose ka performance te dobet, klientit duhet t'i garantohet vazhdimesia e sherbimit. Kjo arrihet duke u mbeshtetur ne rrjetet ekzistuese 2G, qofte per sherbimet me Komutim me Qark, qofte per sherbimet me Komutim me Pakete.

Permbledhtazi mund te themi se teknologjia UMTS ofron gjeresi me te madhe brezi dhe akses me te shpejte per sherbimet online.

Komenti i AKEP :

Teknologjia UMTS do te jete nje hop ne ofrimin e ketyre sherbimeve duke permiresuar ndjeshem cilesine dhe shpejtesine e transmetimit. Natyrisht qe per transmetim te dhenash (internet, data te natyrave te ndryshme, multimedia) UMTS ofron kapacitete dhe cilesi me te medha se GSM. Edhe ne kete drejtim operatoret jane optimiste se ndikimi i 3G do te jete nje hap i madh perpara

Pyetje:

AKEP mendon qe vlefshmeria e nje autorizimi te leshuar te jete 10 vjet.

9- A jeni dakort me kete kohezgjatje vlefshmerie autorizimi? Ne se jo, sa mendoni?

A-

Ne gjykojme se kohezgjatja e vlefshmerise se te drejtave te frekuencave te rrjetit UMTS duhet te jete 15 vjet, e cila eshte ne linje me dispozitat e autorizimit individual te vlefshmerise se kohezgjatjes se perdorimit te frekuencave, e aplikuar per operatoret e autorizuar 2G.

B-

Investimi ne teknologjine 3G eshte i larte si per asetet ashtu edhe per shpenzimet operacionale. Nese mendojme qe synojme edhe cmime te arsyeshme per perdoruesit fundore (te perballueshme per nivelin ekonomik te populates), mendojme qe afati duhet te jete te pakten 15 vjet. Vetem ne kete menyre operatoret do te kene mundesi qe te amortizojne ne kohe investimin.

C-

Ne nuk jemi dakort me afatin 10-vjecar te propozuar nga AKEP per autorizimet UMTS. Nje operatori qe fiton nje autorizim UMTS, do t'i duhet nje investim i madh per te zhvilluar rrjetin UMTS, dhe kostoja e ketij investimi mune te rimerret pas nje periudhe te konsiderueshme. Nje afat 10-vjecar eshte shume i shkurter qe te mundesoje perkushtimin e fondeve te nevojshme per investim.

Per kete arsye, afatete e autorizimeve neper Evrope jane me te gjata se 10 vjet. Sic tregohet edhe ne faqen zyrtare te ERO (<http://www.ero.dk/umts>), afati i dhene per autorizimin eshte 20 vjet, ndersa vetem ne raste te rralla, jane dhene autorizime UMTS me afat me te shkurter se 15 vjet. Ne do te donim te nxisnim AKEP te ndiqte standarte Evropiane dhe te ofronte te pakten nje afat 20-vjecar per keto autorizime.

D-

Ne konsiderojme se analiza e bere nga AKEP tregon qarte se tregu mund te sherbehet njekohesisht pa problem me te drejtat per te gjitha spektrin UMTS. Del qarte nga konsultimi publik se ka spekter te mjaftueshem per t'u disponuar nepermjet 4 (kater) autorizimeve.

*Ne konsiderojme se Qeveria dhe AKEP duhet te fokusohen per t'iu mundesuar operatoreve ekzistues **te hyjne ne treg ne te njejten kohe dhe te arrijne sa me shpejt te jete e mundur nje perqindje mjaftueshmerisht te larte te penetrimit te internetit me brez te gjere.***

*Duhet mbajtur parasysh gjithashtu se palet qe duhet te lejohen ta marrin pjese ne tender, **ne rast se do te mbahet nje tender publik per autorizimet, keta duhet te jene aplikante me nje reputacion te mire se dhe eksperience te gjere e te vertetuar ne sektorin e komunikimeve elektronike.***

Ne konsiderojme se AKEP duhet te ishte konsultuar ne menyre te shprehur me publikun per numrin e te drejtave te spektrit qe do te jepen. Kjo eshte nje kerkese ligjore e Nenit 68.1. b. AKEP duket se shmang konsultimin (nuk jane bere pyetje te posacme ne Dokument) ne lidhje me numrin e te drejtave te perdorimit dhe nevojen per t'u kujdesur per te drejtat e perdoruesve dhe per konkurrencen ekonomike (Neni 68.4).

Sipas qasjes procedurale ne lidhje me kete ceshtje, ne konsiderojme se hapat e meposhtem jane te detyrueshem per t'u ndjekur sipas Ligjit 9918 date 18.05.2008 " Per Komunikimet Elektronike" :

- *AKEP duhet se pari te konsultohet per numrin e autorizimeve qe pritet te jepen (4 autorizime). Nga teksti i konsultimit duket se AKEP do te jape kater autorizime por kjo duhet te behet e qarte ne konsultim, ne baze te Nenit 68.b te Ligjit dhe ne baze te parimit te sigurise dhe qartesis ligjore. AKEP nuk duhet te krijojte pasiguri per operatoret aktuale dhe sidomos per investitorët e ardhshem.*
- *Ne Pjesen 2 te dokumentit te konsultimit, AKEP duhet te pyese palet zyrtarisht nese ato jane te interesuara per te marre autorizime 3G, ne menyre qe konsultimet te jene te vlefshme dhe te marre **shprehje interesi zyrtare** nga palet e interesuara.*
- *Vetem nese ne baze te konkluzioneve te konsultimit publik gjendet se kerkesa e paleve per autorizime tejkalon spektrin e disponueshem (d.m.th me shume se kater kerkesa per kater*

autorizimet e disponueshme), AKEP zbaton proceduren e tenderit publik pas miratimit te Ministrit.

- Ministri duhet te miratoje proceduren e tenderit sipas kerkesave ligjore dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave per kete ceshtje.
- Procedura duhet te jete transparente, objektive, jo-diskriminuese dhe e barabarte.

Ndersa per kohezgjatjen e vlefshmerise se autorizimit kemi komentimin e meposhtem:

Shprehim mendimin se kohezgjatja e vlefshmerise te dhenies se spektrit duhet te jete per 15 vjet, njesoj si kushtet e licenses GSM. Kjo do te krijonte me shume siguri per investitoret qe do te investojne ne 3G. Nje afat me i gjate do te nxiste investimin e nevojshem ne infrastructure per te siguruar shtrirje te shpejte dhe te gjere te sherbimeve UMTS.

Komenti i AKEP:

Kohezgjatja e autorizimit propozohet te jete 15 vjet.

Pyetja:

10- Cila eshte vlera qe jeni te gatshem te paguani per Autorizim sipas percaktimit te bere ne piken 2.4 te ketij dokumenti?

Komenti i AKEP:

AKEP, komentet e marra nga operatoret per vleren e tregut i konsideron ato informacione konfidenciale dhe nuk i ben publike.

11- AKEP fton sipermarresit te formulojne kritere ne lidhje me:

- Ndarjen ne faza per mbulimin me sherbim:
- sipas shtrirjes gjeografike, dhe
- mbulimit te popullsise,
- Sherbime te disponueshme
- telefoni
- internet
- multimedia etj
- Pagesat e operatoreve per akses ne frekuencat e UMTS

A-

S'ka koment

B-

S'ka koment

C-

Do te ishte me mire nese fazat e mbulimit me sherbim te percaktoheshin ne raport me popullsine sesa ne raport me mbulimin gjeografik. Bazuar mbi karakteristikat e vecanta gjeografike dhe shperndarjen e popullsise se vendit, si dhe aftesine financiare te operatoreve, ne do te sugjerim kriteret e meposhtme te mbulimit:

- 50% e mbulimit te popullsise, 3 vjet pas dhenies se autorizimit
- 70% e mbulimit te popullsise, 6 vjet pas dhenies se autorizimit

-Sherbime te disponueshme

-Telefoni

-Internet

-Multimedia, etj.

Sherbimet qe duhet te jene menjehere te disponueshme duhet te perfshijne telefoni zanore, video telefoni, internet, email, audio dhe video streaming dhe SMS.

D-

Ne lidhje me kriteret e vleresimit, ne konsiderojme se eshte teper e rendesishme te lejohet pjesemarrja ne perzgjedhje vetem e shoqerive qe kane ekperience teknike te provuar dhe qe kane treguar aftesi ne shtrirjen e rrjeteve GSM dhe UMTS qofte ne nivel lokal ose nderkombetar. Keto investime te rendesishme ne kete teknologji te re nuk mund te lejohen te kryhen nga shoqeri pa eksperience ne kete fushe.

Teknologjite e reja dhe ne vecanti rrjetet 3G/HSPA shpesh maten ne baze te mbulimit te popullsise (qe merr sherbim) ne vend te mbulimit fizik. Kjo ndodh me se shumti per shkak te faktit se ne shumicen e rasteve, keto tipe rrjetesh ndertohen si mbivendosje e rrjetit/stacioneve GSM dhe jo si implementim i rrjetit direkt me 3G.

Ne kendveshtrimin tone , do te ishte perfituese per te gjitha aplikantet/ palet e interesuara per licensat 3G/HSPA qe te shtrijne rrjetin me disa **kerkesa realiste per mbulimin**, ne menyre qe te kete sukses ne zhvillimin e ketij tregu drejt 3G/HSPA. Kjo pritet te jete ne linje me politikat e AKEP dhe Qeverise Shqiptare per te krijuar nje mjedis konkurrues dhe cmime te arsyeshme per perdoruesin fundor ne periudhen afat gjate.

Me poshte kemi sugjeruar detyrimet per mbulim qe mund te ekzistojne ne linje me planin kohor/ ritmin e shtrirjes se rrjetit qe jane edhe me te shpejta se ritmet e shtrirjes se rrjeteve perkatese ne Europe:

1. Dhenia e Licenses
1. 12 muaj : 30% e popullsise
2. 24 muaj : 50% e popullsise
3. 36 muaj : 60% e popullsise
4. 48 muaj : 64% e popullsise

Ne lidhje me disponueshmerine e sherbimeve, ne konsiderojme se kjo eshte e nje rendesie teper te madhe, sidomos duhe patur parasysh nevojat e Qeverise per te rritur ne menyre te konsiderueshme perqindjen e penetrimit te internetit me brez te gjere.

Ne konsiderojme se cmimi per te drejten e perdorimit te spektrit UMTS nuk eshte i nje rendesi primare. Per te gjitha arsyen e dhena ne dokumentin e konsultimit , ne besojme fuqimisht se Qeveria duhet te perqendrohet ne :

- *Terheqjen e investimeve ne kapacitetin e rrjetit dhe mbulimin (dhe te popullates dhe gjeografike)*
- *Stimulimin e perdorimit te internetit nga popullsia dhe dixhitalizimin e shoqerise*

Arritja e sa me siper dhe mbledhja e te ardhurave te konsiderueshme nga dhenia e spektrit jane ne kontradike me njera tjetren.

Ne lidhje me pagesen e operatoreve per te aksesuar frekuencat UMTS, ne konsiderojme se nje pagese e vetme per autorizimin eshte e mjaftueshme per operatoret qe ata te kene mundesi te perdorin frekuencat gjate gjithë kohezgjatjes se licenses. Theksojme se regjimi i tanishem i pageses se dyfishte per frekuencat GSM (nje si takse per buxhetin e shtetit dhe nje tjetër si tarife per AKEP) duhet te shfuqizohet dhe te mos perseritet per frekuencat 3G, duke qene se kjo do te frenonte investimet ose do te bente qe investimet te ishin me te shtrenjta, qe do te reflektohet ne cmimet e pakices se 3G.

Komenti i AKEP:

AKEP mendon qe 2 (dy)muaj nga data e pajisjes me Autorizim Individual operatori duhet te filloje ofrimin e sherbimit, gjithashtu do te vendosen kushte te tjera per mbulimin e territorit me sinjal.

Pyetja:

12- A ka ndonje ceshtje tjetër per tu marre ne konsiderate ne kete proces?

A-

Ne sugjerojme te merren ne konsiderate ceshtje te tjera shtese si me poshte :

- *AKEP duhet te percaktoje numrin e sakte te Autorizimeve qe do te leshohen. Ne dokument permendet se e drejta e perdorimit mund te jete deri ne 4. Ne propozojme qe te jepen 4 autorizime ne te njejten kohe , duke plotesuar kerkesat e tregut aktual te telefonise celulare ne Shqiperi, por edhe ne favor te rritjes se konkurrences efektive. Mosdhenia ne te njejten kohe e autorizimeve te UTMS do te shkaktoje efekte negative ne tregun e telefonise celulare ne te ardhmen.*
- *AKEP duhet te percaktoje teknologjine FDD ose TDD. Teknologjia TDD nuk eshte shume e perdorur ne praktikate boterore, si pasoje e interferencave te medha ne Cross-Slot. AKEP mund ti ndaje ne Autorizime FDD dhe TDD, ne rastet kur nuk deshirohet te perdoren TDD. Nese do te jepen FDD/TDD se bashku, frekuencat TDD nuk do te perdoren sepse jane nje zgjidhje hibride. Sistemi hibrid FDD-TDD zevendeson disa kanale nen perdorim FDD UL nga kanalet me qellim qe te mbeshtese trafikun asimetric.*
- *AKEP duhet te percaktoje proceduren e dhenies se autorizimeve. AKEP duhet te favorizojte dhenien e Autorizimeve ne funksion te kushteve te tregut shqiptar. Ne sugjerojme qe AKEP duhet te fokusohet per kritere te tilla si shtrirja e rrjetit dhe mbulimi me sinjal i popullsisë. Ne pergjithesi zgjidhja e nje procesi qe mund te siguroje sukses eshte promovimi i mjediseve efektive dhe konkurruese. Nderkohe qe efektiviteti mund te arrihet nepermjet zbatimit te politikave te sakta nga rregullatorët , konkurrenca mund te*

stimulohet dhe promovohet ne menyre te ndryshme. Qellimi perfundimtar eshte zhvillimi teknologjik dhe ofrimi i sherbimeve ne interes te publikut.

- *Ofrimi i 3G duhet te jete eskuzivitet vetem i kompanive celulare qe ofrojne 2G te cilat e kane standardizuar kete sherbim dhe jo i kompanive te tjera, ofrues te Internetit ose data transmission, me qellimin e vetem sigurimin e larte te sherbimit si edhe mbulimin e kerkuar me sinjal ne perputhje me standartet e ofrimit te sherbimit UMTS.*

B-

Ne do t'i sugjeronim AKEP qe te marre ne konsiderate faktin se sa me te larta te jene pagesat per Autorizimet Individuale, aq me e veshtire do te jete per operatoret te ofrojne cmime te perballueshme per tregun konsumator te sherbimeve 3G. Nese ndodh, ky fenomen do te coje ne uljen e ritmit te penetrimit te tregut te perdoruesve te sherbimeve 3G. Kjo behet akoma me e rendesishme ne nje treg si Shqiperia, ku mundesite e konsumatorit per akses ne keto sherbime jane te limituara per shkak te penetrimit te ulet te telefonise fikse dhe presences se ulet ne mbulim te kompanive ISP.

C-

Ne vijim, do te donim te permblihdhim pikat kryesore te shprehura me lart:

- *Ne besojme se do te kete nje kerkese te larte per sherbimet e bazuara ne teknologjine UMTS, sidomos per shkak te norms se ulet te penetrimit te sherbimeve DSL, dhe si rrjedhoje edhe kerkes te larte te mundshme per sherbimet celulare me brez te gjere. Ne e nxisim AKEP qe te filloje sa me shpejt te jete e mundur procesin e dhenies se autorizimeve.*
- *Ne propozojme qe te lejohet perdorimi i sherbimeve UMTS jo vetem ne brezin e frekuencave 2100 MHz, por edhe ne brezin e frekuencave 900 MHz dhe 1800 MHz. Ne ju rikujtojmë te tendencen drejt teknologjive neutrale qe aplikohet ne te gjitha ankandet e frekuencave ne mbare boten.*
- *Afati 10-vjecar i propozuar per vlefshmerine e autorizimit eshte shume i shkurter nese operatoret duhet te kene mundesine per te rifituar investimet ne rrjetet UMTS. Ne propozojme qe duhet te ofrohet nje afat vlefshmerie prej 20 vjetesh.*
- *Tarifa e autorizimit duhet te jete me e ulta e mundshme, ne menyre qe operatoret te mund te investojne ne rrjetet UMTS, si dhe te zhvillojne sherbime te reja celulare me brez te gjere.*
- *Ne besojme se autorizimet duhet te alokohen nepermjet nje konkursi (beauty contest). Kriteri kryesor per dhenien e autorizimeve duhet te jete aftesia e provuar e ofruesve per te ndertuar dhe operuar rrjete celulare te nje cilesie te larte. Prioritet me te larte duhet t'u jepet operatoreve ekzistues celulare GSM, te cilet kane kalimin nga teknologjia 2G ne ate 3G, si shtegun e tyre natyror te rritjes dhe zhvillimit.*

D-

Ne lidhje me shtrirjen e 3G, shtrirja e lidhjes me fiber eshte shume e rendesishme sidomos rrjeti themelor me fiber. Per kete arsye, ne mendojme se AKEP dhe Qeveria, ne linje me deklaratat e Politikes per komunikimet elektronike duhet te marrin sa me shpejt nje vendim ne lidhje me strategjine per rrjetin themelor me fiber (fiber backbone network), per te permbushur misionin e tyre per shtrirjen e ekonomise dixhitale dhe krijimin e kuadrit te duhur ligjor dhe rregullator me mundesi te barabarte dhe te hapura per te gjitha palet qe duan te kryejne investime.